



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 631/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për periudhën pesë vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Mjekësi e Përgjithshme, Dr.Med, 360 ECTS, (maksimum 150 studentë për vit akademik);
- Stomatologji, Dr. Dent, 360 ECTS, (maksimum 70 studentë për vit akademik);
- Farmaci, Mr.Ph, 300 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
- Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS, (maksimum 5 studentë për vit akademik);
- Mjekësi Klinike, PhD, 180 ECTS, (maksimum 10 studentë për vit akademik);
- Stomatologji, PhD, 180 ECTS, (maksimum 10 studentë për vit akademik).

II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Biomjekësi Eksperimentale, PhD, 180 ECTS, (maksimum 3 studentë për vit akademik);
- Shëndeti Publik, PhD, 180 ECTS, (maksimum 3 studentë për vit akademik);
- Fizioterapi, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
- Infermieri, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik).

III. Nuk ri/akreditohet programi i studimit:

- Mami, BSc, 180 ECTS.

- IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- V. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- VI. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Mjekësi e Përgjithshme	Dr.Med	360	Mehmedali Azemi, Rexhep Hoxha, Hasan Ahmeti
2	Stomatologji	Dr.Dent	360	Fatmir Dragidella, Blerim Kamberi, Kujtim Shala
3	Farmacii	Mr.Ph	300	Adnan Bozalia, Kreshik Hoti, Dashnor Nebija
4	Infermieri	BSc	180	Sylejman Rexhepi, Isme Humolli, Antigona Hasani
5	Mami	BSc	180	Fehmi Zeqiri, Myrvete Paçarada, Lidvana Spahiu
6	Fizioterapi	BSc	180	Hajrije Hundozi-Hyseni, Vjollca Sahatçiu-Meka, Faton Morina
7	Mjekësi Paraklinike	PhD	180	Burim Neziri, Ragip Shabani, Hilmi Islami
8	Mjekësi Klinike	PhD	180	Nexhmi Hyseni, Salih Ahmeti, Shemsedin Sadiku
9	Shëndeti Publik	PhD	180	Tahire Gjergji-Maloku, Sefedin Muçaj, Merita Koçinaj-Berisha
10	Stomatologji	PhD	180	Metush Disha, Gloria Staka, Resmije Ademi Abdyli
11	Biomjekësi Eksperimentale	PhD	180	Suzana Manxhuka-Kërliu, Zana Baruti-Gafurri, Shaip Krasniqi

AKA ka organizuar dy vizita në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Vizita e parë është realizuar më 06.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Markus Paulmichl, Prof. Dr. Ulrike Stephanie Webersberger, Prof. Dr. Charity Nofziger. Vizita e dytë është realizuar më 10.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Wolfgang Patsch, Prof. Dr. Helvi Kyngas, Mr. Adrian Stan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Mami, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Për Ekipin e Ekspertëve, problemi më serioz është që në këtë program të studimit asnjë mësues nuk është nga fusha e mamisë. Po ashtu asnjë mami nuk është paraparë në trajnimin klinik për të mentoruar studentët. Sipas ekspertëve kjo është në kundërshtim me direktivën e BE-së. Rezultatet e pritura të mësimit janë shpjeguar në RVV mirëpo janë të një niveli të përgjithshëm. Rezultatet e mësimit duhet të jenë më të sakta dhe duhet të shkruhen në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/55EU. Po ashtu, për sa i përket literaturës së studentëve, ekspertët kanë mësuar se ka libra të vjetër dhe literaturë të vjetërsuar e cila nuk ka për fokus maminë. Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë thënë se ka mungesë të qartë të stafit akademik të cilët janë të fushës së mamisë.

Është thënë se ka mbështetje ndërkombëtare mirëpo jo për sa i përket mësimit dhe mentorimit të trajnimit klinik. Pra sipas ekspertëve stafi akademik nuk përmbush Direktivën e BE-së dhe është nën nivelin e kësaj direktive. Për sa i përket infrastrukturës, ekspertët kanë thënë se përgjithësisht për mësime praktike, Universiteti ofron hapësira të mjaftueshme mirëpo për sa i përket laboratorëve dhe infrastrukturës së duhur për programin e Mamisë, kjo infrastrukturë nuk mbulon nevojat e studentëve për të ushtruar aftësitë e duhura.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë